



## Termet e referencës

# Grupi Punues për Çështje Shoqërore- Ekonomike

### QËLLIMI

Ky dokument përmbledhë përshkrimin e punës për Grupin Punues për çështje shoqërore-ekonomike për përpilimin e Strategjisë për Digjitalizim të Republikës së Kosovës (tash e tutje Strategjia) me qëllim të arritjes së objektivit Nr.1 të KPM-së për vitin 2010.

Grupi Punues për çështje shoqërore-ekonomike është themeluar me vendimin Nr. 0901/0045/KKPM/dd të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media për të hartuar pjesën shoqërore-ekonomike të strategjisë.

### FUNKSIONI

Funksioni i Grupit Punues për Çështje Shoqërore-ekonomike është të hartojë pjesën Shoqërore-ekonomike të Strategjisë, të merr pjesë në takime me publikun për diskutimin e draftit, të bashkëpunojë me katër grupet tjera punuese për strategjinë e digjitalizimit dhe të jap kontributin e tyre në finalizimin e Strategjisë.

Funksioni i Grupit punues skadon me finalizimin e Strategjisë.

### PËRBËRJA E GRUPIT PUNUES:

*Grupi punues për Çështje Shoqërore-ekonomike përbëhet nga këta anëtarë:*

Emri	Pozita
1. Venera Hajrullahu	Kryesuese, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
2. Arben Bilalli	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
3. Ganimete Nuçi	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
4. Korab Gashi	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
5. Labinota Mehmeti	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
6. Faruk Rexhaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
7. Nalan Abazgjik	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
8. Selim Thaqi	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF)
9. Gani Koci	Komisioni për buxhet dhe financa (Kuvendi i Kosovë)
10. Berat Rukiqi	UP/Oda Ekonomike
11. Linda Shala	Sektori Privat

12. Hajrullah Çeku	KPJ
13. Ruzhdi Halili	Zyra për Planifikim Strategjik (Zyra e Kryeministrit)
14. Mentor Shala	RTK
15. Durime Perjuci	KTV
16. Eugen Saracini	TV 21
17. Linda Fazliu	AMPEK/Mediat Lokale
18. Ilir Murtezi	AMPEK/Mediat Lokale
19. Florent Perjuci	OK Kujtesa
20. Ramadan Berisha	CEO, Business Channel 1 TV

## **OBLIGIMET E ANËTARËVE TË GRUPIT**

Të gjithë anëtarët e grupit duhet:

- T'i respektojnë termat e referencës së Grupit;
- Të pranojnë një kopje dhe të lexojnë ligjin për KPM-në dhe materialet tjera të prodhuara nga aktivitetet e KPM-së për digjitalizim dhe materialet tjera relevante që kanë të bëjnë me punën e përgjithshme të KPM-së.
- Të deklarojnë konflikt (eventual) të interes në fillim të takimit.
- Të kenë pjesëmarrje aktive në të gjitha takimet, duke ju përgjigjur ftesës së dërguar përmes Sekretariatit. *Në raste të jashtëzakonshme kur anëtari nuk do të ketë mundësi të marrë pjesë në takim informon Kryesuesin e Grupit Punues përmes Sekretariatit për zëvendësim.*
- Të japin kontribut aktiv në grup punues duke dhënë komente rreth përmbajtjes teknike të Strategjisë dhe mbi çështjet që duhet adresuar
- Të ndihmojnë në përpilimin e dokumentit final.

## **EKSPERTIZA E BRENDSHME, PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE DHE PALËVE TJERA ME INTERES -DETYRAT SPECIFIKE**

Përveç obligimeve të cekura më lartë ekspertët e vendit si dhe përfaqësuesit e organizatave/institucioneve dhe palëve tjera me interes kanë për obligim :

- Të japin ekspertizën e tyre relevante gjatë përpilimit dhe finalizimit të strategjisë.
- Të paraqesin perspektivën e institucioneve të tyre në lidhje me planin strategjik dhe procesin e digjitalizimit në përgjithësi;
- Të japin informata për grupin punues duke ndihmuar përshtatjen e planit strategjik në sferën e fushveprimtarisë së tyre dhe interesit të përbashkët në këtë aspekt.

## **EKSPERTIZA E JASHTME**

*Grupi Punues për Çështje Shoqërore-ekonomike ka të drejtë që kohë pas kohe të kërkojë ndihmë nga ekspertë të jashtëm për çështje të caktuara për të cilat mungon ekspertiza brenda grupit punues në Kosovë. Në këtë rast, Grupi Punues do t'ia paraqesë këtë kërkesë Kryesuesit përmes Sekretariatit.*

Ekspertët e jashtëm do të angazhohen në bazë të kriterëve specifike të përcaktuara nga KPM.

## **REKOMANDIMET PËR VENDIME**

GP i propozon Këshillit të KPM-së rekomandimet e veta për marrjen e vendimeve për çështje të rëndësishme të veçantë të cilat mund të dalin gjatë procesit të hartimit të pjesës Shoqërore-ekonomike të strategjisë.

*GP harmonizon draftin e pjesës Shoqërore-ekonomike të strategjisë duke evidentuar edhe kundërshtimet dhe të tilla ia përcjell Këshillit të KPM-së për shqyrtim dhe miratim.*

## **TAKIMET**

Grupi Punues për Çështje Shoqërore-ekonomike do të takohet të paktën një herë në muaj.

Agjenda e takimeve dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën e Grupit Punues për Çështje Shoqërore-ekonomike do t'i dërgohen Grupit disa ditë para mbledhjeve që t'u jepet anëtarëve mundësi të familjarizohen me materialet.

Pas çdo mbledhjeje do të hartohet procesverbali i cili do të ratifikohet në mbledhjen e radhës. Pas ratifikimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i Grupit Punues.